



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief State Prosecutor

A.nr. 160/2021

Datë: 27/05/2021

Prishtinë;

Kryeprokurori i Shtetit, në pajtim me nenin 1 paragrafi 1 dhe pika 1.1, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit nr.05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit me qëllim të ngritjes së efikasitetit në aplikimin e ndërmjetësimit si procedurë alternative për rastet dhunës në familje dhe me qëllim të zbatimit unik të praktikave pas ndryshimeve në Kodin Penal nxjerr këtë:

UDHËZIM

Për Negocimin e Marrëveshjes mbi Pranimin e Fajësisë

- 1) Marrëveshja për Pranimin e Fajësisë është institut që i jep të drejtë prokurorit të shtetit që në çdo kohë gjatë Procedurës Penale e deri te momenti i përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të negocioj kushtet dhe të arrijë marrëveshjen e shkruar për pranimin e fajësisë.
- 2) Marrëveshja për Pranimin e Fajësisë duhet të jetë e mbështetur në fakte dhe prova materiale të cilat paraqiten në aktakuzë dhe kualifikimin ligjor për të cilin i pandehuri do ta pranoj fajësinë.
- 3) Marrëveshja për Pranimin e Fajësisë mund të bëhet në tërësi apo edhe vetëm për disa akuza.
- 4) Negociatat për pranimin e fajësisë nuk duhet të shihen në asnjë moment si një mënyrë e ujdisë për akuzat nëse ka dëshmi që do të shpien drejt ndjekjes penale të një individi për këto akuza dhe as nuk implikon ekzistimin e negociatave për akuzat gjatë hetimeve, as mundësinë që të hudhën poshtë disa nga akuzat në këmbim të marrëveshjes së pranimit të fajësisë.
- 5) Marrëveshja për Pranimin e Fajësisë në formë të shkruar nuk duhet të përmbajné asnjë kusht që mund të ndikoj tek prokurori i shtetit për të mos i filluar hetimet për ndonjë krim ose të hudhë poshtë kallëzimin penal apo të tërhiqet nga ndjekja penale për veprat për të cilat sipas ligjit në fuqi hetohen ose ndiqen sipas detyrës zyrtare.

- 6) Prokurorit të Shtetit bazuar në nenin 233, paragrafi 1. të Kodit të Procedurës Penale (KPP) i lejohej që në çdo kohë para ngritjes së aktakuzës me mbrojtësin e të pandehurit të negocioj kushtet e marrëveshjes së shkruar për Pranimin e Fajësisë, ku shprehimisht në bazë të këtij neni, prokurori i shtetit dhe i pandehuri pajtohen për akuzat e përfshira në aktakuzë dhe i pandehuri pajtohet të pranoj fajësinë në shkëmbim siç parashihet me nën-paragrafin 1.1 dhe 1.2 të nenit 233 të KPP-së.
- 7) Prokurori i Shtetit, bazuar në nenin 233, para 2. të KPP, i lejohej në çdo kohë pas ngritjes së aktakuzës dhe para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, prokurori i shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes së shkruara për pranimin e fajësisë, në bazë të së cilës i pandehuri pranon fajësinë në shkëmbim siç parashihet me par 2. nën paragrafin 2.1 dhe 2.2 të nenit 233 të KPP-së.
- 8) Prokurori i Shtetit ka vetëm mundësitë vijuese që t'i ofrojë të pandehurit, në këmbim të pranimit të fajësisë.
 - a) Sa i përket nenit 233, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.1 dhe paragrafit 6 të KPP-së, rekomandimi për të pandehurin që të dënohet me një dënim shumë më të butë, por jo nën kufijtë e paraparë nga neni 72 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) mund të kombinohet me një rekomandim tjetër i adresuar në gjykatë për të vendosur sipas nenit 71, paragrafit 1.3 të KPRK-së, që i lejon gjykatës të japë një dënim brenda kufjeve të nenit 72 të Kodit Penal, por vetëm deri në shkallën e lejuar me paragrafin 7 të nenit 233 të Kodit të Procedurës Penale, ku prokurori i shtetit mund të rekomandojë dënim më të butë të paraparë sipas nën-paragrafëve 7.1, 7.2, 7.3, 7.4.
 - b) Zbatimi sipas nenit 236 të Kodit të Procedurës Penale në gjykatë për të lëshuar një urdhër ku deklarohet që i pandehuri do të jetë “një dëshmitar bashkëpunues”, ashtu siç përkufizohet me nenin 235 të KPP-së.
 - c) Me kërkesë të prokurorit të shtetit gjykata mund të liroj nga dënimi kryerësit ashtu siç është paraparë me nenin 234 të Kodit të Procedurës Penale.
- 9) Marrëveshja për Pranimin e Fajësisë në formë të shkruar gjithmonë duhet t'i specifikojë “përgjegjësitë e të pandehurit për kompensimin e të dëmtuarit dhe konfiskimi i të gjitha pasurive të cilat i nënshtrohen konfiskimit nga Kapitulli i XVIII i këtij Kodi”, sipas paragrafit 12, nën-paragrafit 12.4 të nenit 233 të Kodit të Procedurës Penale, pavarësisht paraqitjes së kërkesës pasurore-juridike nga ana e palës së dëmtuar. Përgjegjësia e të pandehurit është diçka tjetër nga përcaktimi aktual u dëmit që pala e dëmtuar ka vuajtur, e cila mund të kërkohej gjithashtu edhe në procedurën civile.
- 10) Konfiskimi i objekteve dhe përfitimeve materiale të krimit do të merren parasysh gjatë gjithë negociatave për pranimin e fajësisë.

Prokurorët e Shtetit duhet të sigurojnë që hetimet e domosdoshme janë bërë kundrejt objekteve të përdorura, të fituara ose të destinuara për përdorim në veprën penale ashtu si dhe të gjitha përfitimet materiale të fituara nga kryerja e veprës penale (qoftë nga i pandehuri, palët e treta ose personat ligjor). Neni 233, nën-paragrafi 12.4 i Kodit të Procedurës Penale kërkon në veçanti që marrëveshja për pranimin e fajësisë duhet të specifikojë "konfiskimin e të gjitha aseteve që janë subjekt i konfiskimit sipas kapitullit XVIII të KPP-së".

Nëse është e zbatueshme, prokurorët e shtetit do t'i përfshijë dispozitat në marrëveshjet e pranimit të fajësisë që kanë të bëjnë me konfiskimin e të dyjave, objekteve dhe përfitimeve materiale të fituar nga kryerja e krimit dhe duhet të kërkojnë nga gjykata që të marrin parasysh marrëveshjen për pranimin e fajësisë për të urdhëruar konfiskimin e objekteve dhe konfiskimin e përfitimeve materiale nga krimi.

- 11) Në përputhje me nenin 233 paragrafët 8,9 dhe 12 të KPP-së, gjatë procedurës për negociimin e marrëveshjes së pranimit të fajësisë, prokurori i shtetit do të parasheh një paragraf në të cilin i pandehuri (të pandehurit) pajtohet (n) për kompensimin e palës së dëmtuar me një shumë të caktuar aq sa janë dëmet e shkaktuara me kryerjen e veprës penale, përfshirë humbjen e përfitimit, dëmtimet morale dhe dëmtimet e tjera jo-monetare, ose të rivendos në një mënyrë tjetër të drejtat e palës së dëmtuar (si psh. nëpërmjet kthimit të objektit).

Prokurori i shtetit duhet të e dëgjoj palën e dëmtuar në përputhshmëri me rrethanat.

Përcaktimi i shumës ose modaliteteve tjera për të rivendosur të drejtat e palës së dëmtuar, e bërë nga prokurori i shtetit dhe i pandehuri, nuk do të kanë ndikim në të drejtat e palës së dëmtuar, nëse pajtueshmëria e arritur nuk është e mjaftueshme për rivendosjen e të drejtave të tij/saj.

- 12) Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse nuk do të autorizoj asnjë marrëveshje për pranim të fajësisë me të pandehurin, nëse i pandehuri nuk pranon kthimin e përfitimeve materiale nga një vepër penale ose të kompensojë apo rivendosë palës së dëmtuar të drejtat, ose nëse marrëveshja për pranimin e fajësisë është në kundërshtim me dispozitat e ligjit në fuqi.
- 13) Në të gjitha negociatat kur i pandehuri dëshiron të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi në pajtim me paragrafin 1 të nenit 233 të Kodit të Procedurës Penale.
- 14) Në rastet kur prokurori i shtetit dëshiron të arrijë marrëveshje për pranimin e fajësisë merr miratimin e Kryeprokurorit të zyrës së tij përkatëse për të filluar negociatat për pranimin e fajësisë, bazuar në paragrafin 5, nën paragrafin 5.1 dhe 5.2 të nenit 233 të KPP-së.
- 15) Marrëveshja më shkrim për pranimin e fajësisë duhet të përmbajë të gjitha kushtet e marrëveshjes dhe para se të dorëzohet në gjykatë duhet të jetë e nënshkruar nga Kryeprokurori i zyrës përkatëse, mbrojtësi dhe i pandehuri.

16) Nëse gjykata bindet se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara në paragrafin 18 të nenit 233, gjykata pranon marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe urdhëron që marrëveshja të vendoset në shkresat e lëndës në gjykatë.

Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Kryeprokurori i Shtetit.

Ky udhëzim e shfuqizon udhëzimin e mëparshëm të datës 12 nëntor 2013.

Mos respektimi i këtij udhëzimi mund të konsiderohet si shkelje të Kodit të Etikës për prokurorë.

Kryeprokurori i Shtetit

Aleksandër Lumezi



Udhëzimi i dërgohet;

- Kryeprokurorëve të prokurorive përkatëse dhe të gjithë prokurorëve të shtetit.
- Arkivit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH).

Obligohet administrata e ZKPSH-së që këtë udhëzim ta publikoj në ueb faqen e Prokurorit të Shtetit.